



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM
Nr. 401, datë 07.10.2020

PËR
KOMANDIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...}

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës datë 15.09.2020 të gjyqtares znj. {...}, protokolluar pranë Këshillit me aktin nr.4356, datë 15.09.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj. {...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj. {...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, me afat deri në një vit, që mund të ndërpritet ose zgjatet në varësi të rrethanave.
3. Përfundimin e gjyqtares znj. {...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj. {...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, për të cilat ka përfunduar apo është në përfundim hetimi gjyqësor.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR